



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

SYLLABUS i Lëndës BAZAT E IT-së

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Bazat e IT-së
Niveli:	BSc.
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I (semestri I)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Gjeneratat e kompjuterëve. Sistemi kompjuterik. Sistemet operative. Windows. Programet aplikative. Informacionet dhe komunikimet.
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studentëve me historikun e shkurtër të gjeneratës së kompjuterëve, njohja me njësitë themelore të kompjuterit, sistemin operativ Windows, programin aplikativ MS Word, programin aplikativ Powerpoint dhe puna me Internet. Aftësimi për të shfrytëzuar programet aplikative në lëndët përkatëse gjatë katër viteve të studimit dhe më tutje. Njohja e llojeve dhe karakteristikave të kompjuterëve dhe principi i punës së tyre. Aftësimi i studentëve që çdo problemi t'i ofrohen në mënyrë studioze dhe në mënyrë logjike të lidhin faktet dhe përvojat e fituara. Fitimi i bazave për zbatimin praktik të suksesshëm të njohurive nga ky lëmë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që:1. Të njeh pjesët themelore të kompjuterit dhe lidhje e tyre;2. Të përdor sistemin operativ WINDOWS;3. Të harton fajlla përkatëse në programin aplikativ;4. Të ndërton tabela dhe vizatime të ndryshme;5. Të harton bazën e shënimeve duke shfrytëzuar programin aplikativ Word; 6. Të krijoj prezente në programin aplikativ PowerPoint; 7. Të realizon marrjen e informacioneve dhe komunikimet me Internet.

Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Detyra shtëpie	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	3	3
Koha e studimit vetanak të studentit	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Totali			125
Metodologjia e mësimëdhënies:	Ligjërata, Analiza e materialeve të shpërndara gjatë ligjëratave, Ushtrime, Puna individuale, Puna praktike në kompjuter individualisht, Punime seminarike.		
Metodat e vlerësimit:	Pjesa praktike nga ushtrimet, testi i parë dhe testi i dytë. Pjesa praktike 50% dhe pjesa teorike 50%.		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Dr.sc.Edmond Beqiri: Bazat e informatikës, Universiteti Prishtinës, Prishtinë, 2006. 2. Graham Brown, Brian Sargent, David Watson, Information and Communication Technology, Second Edition, Cambridge ICSE, 2014 3. David Moursund, Introduction to Information and Communication Technology, 2005 4. Vehbi Ramaj, Bazat e informatikës, UP, 2011 5. Dr.sc. Edmond E.Beqiri: Interneti-komunikimet kompjuterike, IOM Prishtinë, 2002		
Literatura shtesë:	1. ECDL – European Computer Driving Licence – Syllabus 4- Prishtinë 2005 2. Dr.Agni Dika, Mr.Sebe Rodiqi: Kompjuterët dhe informatika, Prishtinë, 1999. 3. Materiale të tjera aktuale		
Plani i dizajnuar i mësimi:			

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Historik i shkurtër i zhvillimit të kompjuterëve. Shfrytëzimi i softverit multimedial për sistemin e informimit në përgjithësi. Bazat matematikore dhe logjike në shkencën e informatikës. Mënyrat e paraqitjes së karaktereve dhe kodimi të pajisjet IT.
Java e dytë:	Hardveri, karakteristikat e sistemit kompjuterik. Njësia hyrëse. Tastiera. Maus. Skeneri. Njësia dalëse. Njësia qendrore. Kujtesa. Softveri. Gjuhët programuese. Kompajleri. Sintaksa dhe semantika.
Java e tretë:	Sistemi operativ WINDOWS. Desktopi. Dritaret. Hapja e dritares. Shiritat rrëshqitës. Ndërimi i madhësisë së dritares. Zhvendosja e dritares. Mbyllja e dritares. Menytë. Dialogjet, Ndihma. Dalja nga Windowsi.
Java e katërt:	Mënyra të startimit të Windowsit. Startimi dhe mbyllja e aplikacioneve. Puna me më shumë dritare. Kopjimi dhe zhvendosja mes dritareve. My Computer. Windows Explorer. Krijimi i fajllave dhe i folderave. Zgjedhja e fajllave dhe e folderave. Kopjimi i fajllave dhe i folderave. Zhvendosja e fajllave dhe e folderave. Gjetja e fajllave dhe e folderave. Përshtatja e desktopit dhe menysë Start.
Java e pestë:	Disqet. USB flash. CD-të. Formatizimi. Kopjimi. Control Panel. Magjistaret. Add New Hardware. Add/Remove Programs. Date/Time. Fontet. Display. Keyboard. Mouse. Printerët. System. Shtypja. Multimedia. Rrjeti Kompjuterik. System Tools. ScanDisk. Disk Defragmenter.
Java e gjashtë:	Mënyrat e lëshimit në punë të programit aplikativ WORD. Dritarja kryesore. Menya kryesore. Tastet kryesore. Tastet jokryesore. Tastet për paraqitje në ekran. Tasti Start. Shiriti për formatizim. Shiriti standard. Shiriti i tabelave. Shiritat tjerë. Zhvendosja e shiritave.
Java e shtatë:	Shkruarja e tekstit. Lëvizja nëpër tekst. Lëvizja përmes tastierës. Lëvizja përmes mausit. Ruajtja e tekstit në disk. Hapja e fajllit. Hapja e fajllit të ri. Hapja e fajllit ekzistues. Dalja nga Wordi. Gjetja dhe korrigjimi i tekstit. Gjetja e tekstit. Zëvendësimi i tekstit. Zgjedhja e tekstit. Kopjimi, zhvendosja dhe fshirja e tekstit. Tipi i shkronjave. Zgjedhja e attributeve të shkronjave. Madhësia e shkronjave. Zgjedhja e njëkohshme e parametrave të tekstit. Dukja e shkronjave në ekran. Simbolet jostandarde. Krijimi i shkurtesave. Simbolet e veçantë. Format e paraqitjes së dokumentit në ekran. Paraqitja Normal. Paraqitja Online Layout.
Java e tetë:	Përcaktimi i titujve që shfletohen. Paraqitja Page Layout. Paraqitje Outline. Përcaktimi i nivelit të titujve që shihen. Përcaktimi i tekstit që shihet. Ndryshimi i niveleve të titujve. Zhvendosja e titullit të caktuar. Paraqitja Full Screen. Ndarja

	e ekranit në dy pjesë. Përcaktimi i faqes. Madhësia e letrës. Margjinat. Numrat e faqeve. Headeri dhe footeri. Opcionet për header/footer. Ndarja e dokumentit në dy pjesë.
Java e nëntë:	Efekte të ndryshme. Teksti nën konizë. Hijezimi i prapavisë. Dhëmbëzimi i tekstit. Barazimi dhe centrimi i rreshtave. Zbrazëtirat para dhe pas paragrafit. Ndarja e rreshtit në fund. Distanca në mes rreshtave. Tabulatorët. Mundësi të ndryshme. Stilet. Stili i paragrafit. Zgjedhja e fontit. Shfrytëzimi i stilit. Zgjedhja e parametrave të tjerë. Modifikimi i stilit. Stili i karaktereve. Shkruarja e formulave. Tabelat. Krijimi i tabelës. Zgjedhja e qelive në tabelë. Ndryshimi i hapësirës së qelive. Mbushja e tabelës. Shtimi i qelive. Fshierja e qelive. Kopjimi dhe zhvendosja. Kornizat në tabelë. Vizatimi i vijave me ngjyra. Hijezimi i qelive. Tabela të gatshme.
Java e dhjetë:	Operimi me të dhënat në tabelë. Sortimi. Gjetja e shumës. Grafika në tekst. Insertimi i vizatimeve të Wordit. Shkrimet në WordArt. Insertimi i vizatimeve. Rregullimi i vizatimit të insertuar. Dimensionet dhe pozita e vizatimit. Insertimi i skenimeve. Vizatimi përmes Wordit. Shfrytëzimi i vizatimeve të gatshme. Vizatimi i figurave bazike. Vizatimi i vijave dhe shigjetave.
Java e njëmbëdhjetë:	Ngjyra e vijave. Mbushja e figurave. Vizatimet me hijëzim. Vizatimet tridimensionale. Shkruarja e tekstit. Dukshmëria. Grupimi. Rrafshimi. Rotullimi. Kopjimi dhe fshierja e vizatimit. Teksti në shtylla. Shtypja e tekstit. Ndihma. Korigjimi automatik. Hapja e njëkohshme e disa teksteve. Insertimi i një dokumenti në tjetrin.
Java e dymbëdhjetë:	Shfrytëzimi dhe përshtatja e parametrave të programit PowerPoint. Ngjytja e sllajdeve. Shfrytëzimi dhe rregullimi i pamjeve. Ndryshimi i prapavijës dhe dizajnit të sllajdeve. Aplikimi i shabloneve dizajnuese. Importimi i sllajdeve nga fajllat tjerë.
Java e trembëdhjetë:	Shkruarja, formatizimi dhe editimi i tekstit. Insertimi i objekteve. Diagramet organizative. Vizatimi i objekteve me veglat e programit. Efektet në pamjen e sllajdeve. Fshehja e slljadit dhe prezantimi ritmik. Shtypja e prezantimit.
Java e katërbëdhjetë:	Rrjetat kompjuterike. Topologjitë e rrjetave. Protokolet e rrjetit. Ndarja e rrjeteve.
Java e pesëmbëdhjetë:	Interneti dhe shërbimet e tij.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime, mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular, hyrja në kabinet me kohë etj.